



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, M ëshiruesit!

ME MBRETIN ALFONS PËR SOVRAN HISTORI E SKENDERBEUT

Dr. Aurel Plasari

Të gjitha të drejtat e këtij shkrimi i takojnë autorit

ME MBRETIN ALFONS PËR SOVRAN.....	4
-----------------------------------	---

ME MBRETIN ALFONS PËR SOVRAN

Mbret i Aragonit, Napolit dhe Sicilisë, Alfonsi V shfaqej njëherësh edhe si mbasardhës i normanëve, hohenstaufenëve, angjevinëve, prandaj në kuptimin politik trashëgoi edhe ambicjet e tyre në gadishullin e Europës jug-lindore, qofshin ato të veshura me petkun e "luftës kryqtare"¹. Vinte, pra, e natyrshme prirja e tij për t'u përfshirë me politikën e vet në Lindje të kontinentit, në bazë të të drejtave që mëtonte se i takonin në ato vise, si dhe në sajë të fuqisë së vet dhe dobësisë së "tjetrit". Shpresa e tij ishte që mbi rrënojat e Perandorisë bizantine të ngrinte një shtet të fuqishëm mesdhetar, që do t'i shërbente Europës si ledh kundër dyndjeve nga Azia dhe që do të funksiononte si një koloni e stërmadhe me Napolin për metropol.

Nga ana tjetër, i ndodhur para një fuqie ushtarake si ajo e osmanëve, të cilën e njihte mirë, Skënderbeut i duhej të gjente mbështetje te një fuqi europiane, mundësisht detare-mesdhetare dhe, sidomos, me interesa në Lindje. Shteti papnor, me gjithë politikën e ndihmës dhe mbështetjes, përfaqësonte një fuqi më fort ideologjike, shumë-shumë edhe financiare, por jo ndonjë fuqi efektive politiko-ushtarake, çfarë një prijës i ardhur nga karriera ushtarake me siguri e kishte të qartë. Sa i përket Republikës së Venedikut, njëres prej fuqive më të mëdha të asaj kohe, një mbështetje nga ana

¹ Për këto marrëdhënie JORGA: L'Albanie, 12, 15-16, 23 dhe i gjithë kreu V. NORDEN: Papsttum, 67 dhe vij., 115-117, 329 dhe vij., 478-480, 544-548, 622-623, 626, shën 1. Posaçërisht MARINESCO: Alphonse.

e saj në rangun e proteksionit përjashtoj duke llogaritur sa interesat venedikas të tregtisë në Levant, aq edhe shqetësimet e mundshme për zotërimet që Republika kishte në bregdetin e Arbërisë. Në tetor 1450, si u pa, Skënderbeu bënte veprimin e skajshëm duke ua ofruar Krujën venedikasve, ndërsa Republika e refuzonte duke iu lutur atij "ta mbante për vete"².

Interesat e mbretit Alfons në Europën jug-lindore mbështeteshin te tradita e ekspandimit aragonez në rajonin në fjalë. "Kompania Katalane" i kishte blerë Shtëpisë aragoneze të Siqilisë në atë rajon dukatet e Athinës dhe të Neopatrisë dhe të dyja palët, katalanë dhe aragonezë, kishin njohur sovranitetin e Federikut II të Aragonës, mbret i Siqilisë. Në kohën për të cilën bëhet fjalë këto dy dukate zotëroheshin prej dy vëllezërish Paleologë, Kostandin dhe Thoma, por Alfonsi ia jepte ende vetes titullin "Dukë i Athinës dhe i Neopatrisë" në aktet e tij dhe edhe në legjendën e disa monedhave të prera në Siqili³. Mëtimi i tij mbi këto dy dukate mund të nxirret nga një letër e 27 nëntorit 1444, që mbreti Alfons ua dërgonte dy vëllezërve në fjalë dhe ku afirmonte qartë të drejtat e tij⁴. Për t'u vënë re se, mbas shpartallimit në Varnë dhe deri më 1447, mbreti Alfons thuajse e kishte pezulluar përfshirjen e vet në luftën kryqtare në Lindje. Duke shqyrtuar letërkëmbimin e tij diplomatik, Cerone-ja ka llogaritur se, prej një letre despotit të Moresë Kostandin më 1444 dhe një

² Dokument i përmbledhur në frëngj. te JORGA: Notes, III, f. 260. NOLI: George, f. 200 shën. 111.

³ Për historinë e "kompanisë katalane" dhe marrëdhëniet e saj me aragonezët në Ballkan më gjerë RUBIÓ Y LLUCH: Los Navarros. Edhe FAZELLO: Storia, III, 314 dhe vij. BUCHON: Nouvelles, I, 364 dhe vij.

⁴ "... ducatus Athenarum & Neopatrie, qui nostris iunguntur titulis ad dominium nostrum revocari posse equidem fivimus arbitrati". ACA, Reg. 2690, fl. 123 recto. CERONE: La politica, XXVII, II, 430-431.

tjetre vëllait të tij perandorit Joan Paleologu më 1447, në letërkëmbimin në fjalë vërehet "një golle e konsiderueshme"⁵.

Prej një mesazhi që mbreti Alfons i dërgonte Skënderbeut më 14 dhjetor 1447 mësohet se në oborrin e tij kanë qenë dy të dërguar të prijësit arbër: Fra Antonio de Napoli, komisar apostullor, dhe abati Petro, kushëri [consanguineo] i Skënderbeut⁶. Nga përmbajtja e mesazhit del që Skënderbeu t'i ketë parashtruar mbretit Alfons planin e tij për luftë kundër osmanëve me synim shtënien rish në dorë të zotërimeve të familjes. Mbretit Alfons i kërkohej mbështetje, si dhe një strehim në Pulje në rast shpartallimi të mundshëm⁷. Por duket edhe që Skënderbeu t'i jetë drejtuar atij me terma fetarë, me gjasë me "fjalorin kryqtar", ngase mbreti Alfons në përgjigjen e tij pikësëpari e përgëzonte Skënderbeun për "ngulmimin e mrekullueshëm" në "besimin tonë të përbashkët" dhe shtinte në punë edhe ai formulat e zakonshme të të njëjtit fjalor⁸. Në mesazhin e përgjigjes Mbreti i premonte

⁵ CERONE: po aty, 432. ⁵ CERONE: po aty, 432.

⁶ "Illustris et potens vir, amice noster carissime! Receptis nuper vestris litteris, auditisque plenissime venerabilibus viris, Fratre Antonio de Neapoli, apostolico comisario et abate Petro, consanguineo vestro, vestris ad nos oratoribus, super omnibus iis que vestro nomine nobis exponere voluerunt, vobis breviter rependemus...etc.". ACA, Reg. 2659, fl. 24. MARINESCO: Alphonse, 26, shën. 2. RADONIC: Djuradj, nr. 16.

⁷ Po aty.

⁸ "Nos in primis miram capere voluntatem de vestra in fidem nostram comunem cristianam mirabili perseverancia. Quod vero ad bellum attinet, quod contra Teucris infidelibus inferre instituistis, id quidem laudamus, vosque ad hanc rem magnopere quantum possumus hortamur, de quo, cum pro justitia

ndihmë me disa anije trirremshe, që do t'ia dërgonte kur t'i kthehej flota, si dhe me strehimin e kërkuar. Në drejtimin e letrës shkruhej: "Burrit të shquar dhe të fuqishëm Gjergj Kastrioti ose Skënderbeu, zotërues i Krujës provincë e Arbërisë etj., mik yni shumë i dashur"⁹. Që 1447-a është edhe vit i vendosjes së kontakteve të drejtpërdrejta të Skënderbeut me mbretin Alfons nxirret edhe nga dërgimi prej Mbretit si legat i funksionarit të sekretarisë së tij Bernar Lopez në "Skiavoni", Hungari dhe Arbëri¹⁰.

Në kërkesat për ndihmë që bënte Skënderbeu më 1449, në prag të fushatës së pritshme të sulltanit, qe dalluar përgjigjja e mbretit Alfons, i cili në gusht të atij viti i dërgonte një trupë 1.500 luftëtarësh me pjesë artillerie të lehtë dhe nozullime¹¹. Mbas fitores së 1450-s, ndër ambasadorët që i erdhën me

vestra, quam in recuperandis ab illis Teucris provinciis vestris consequi speratis, tum pro cristiane fidei incremento vos victoriam consecuturum nemo Christi fidelis addubitare potest", po aty.

⁹ "Illustri et potenti viro Georgio Castrioto alias Squenderbegh, domino Croie provinciarumque Arbanie etc., amico nostro carissimo", po aty.

¹⁰ ASN, Cedole della Regia Tesoreria Aragonese, 1446-1447, cedola 9, fl. 447. MINIERI RICCIO: Alfonso, VI, II, 254. 8 "Nos in primis miram capere voluntatem de vestra in fidem nostram comunem cristianam mirabili perseverancia. Quod vero ad bellum attinet, quod contra Teucris infidelibus inferre instituistis, id quiem laudamus, vosque ad hanc rem magnopere quantum possumus hortamur, de quo, cum pro justitia vestra, quam in recuperandis ab illis Teucris provinciis vestris consequi speratis, tum pro cristiane fidei incremento vos victoriam consecuturum nemo Christi fidelis addubitare potest", po aty.

¹¹ FACIUS: De Rebus, IX, 257.

përgëzime duket se ishte edhe ai i Mbretit të Napolit. Si u tha, Barleti tregon se, veç përgëzimeve, Mbreti i Napolit i dërgoi edhe të holla, nozullime dhe punëtorë për të ndrequr muret e dëmtuara të Krujës¹²; Tivarasi/Biemmi mëton se, përpos ndihmës disa mijëra fiorintash, mbreti Alfons i pagoi Skënderbeut edhe borxhet që ai u kishte tregtarëve raguzanë dhe napolitanë¹³. Më e besueshme del që ai t'i ketë marrë përsipër një pjesë të mirë të shpenzimeve të luftës¹⁴.

Në mars 1451 regjistrohet në oborrin e Napolit prania e dy të dërguarve të tjerë të Skënderbeut: peshkopit të Krujës Stefan/Shtjefën dhe domenikanit Nikollë de Berguzzi, të shoqëruar edhe nga një arbër i quajtur Vicino ose Vichino, i përmendur si "majordom" i peshkopit të Krujës¹⁵. 9 "Illustri et potenti viro Georgio Castrioto alias Squenderbegh, domino Croie provinciarumque Arbanie etc., amico nostro carissimo", po aty.

Mbreti Alfons i kërkohej ndihmë për të përballuar ekspeditën osmane që pritej për muajin prill; mbreti premonte të ndihmonte, madje nga ana e tij i dërgonte dy ambasadorë Papës në Romë me një mesazh të 25 marsit 1451, në të cilin i lutej ta ndihmonte edhe ai "të madhërueshmin Gjergj Kastrioti", "që sa me shpirt aq edhe me trimëri ka lufutar kundër turqve"¹⁶. Por prania e

¹² BARLETIUS: Historia, fl. 118 verso-119. 10 ASN, Cedole della Regia Tesoreria Aragonese, 1446-1447, cedola 9, fl. 447. MINIERI RICCIO: Alfonso, VI, II, 254.

¹³ BIEMMI: Istoria, IV, 283.

¹⁴ FACIUS: De Rebus, IX, 332. MARINESCO: Alphonse, passim. PALL: Barlezio, f. 75 shën. 5.

¹⁵ JORGA: Notes, II, 48. MARINESCO: Alphonse, 41.

¹⁶ "... qui tan prestanti animo tanquam viriliter hactenus contra eosdem Theucros se gessit". ACA, Reg. 2546, fl. 132. RADONIC: Djuradj, nr. 37.

ambasadorëve të Skënderbeut në oborrin e Napolit kishte të bënte me një mision më të rëndësishëm: më 26 mars të atij viti ata nënshkruanin në emër të tij me Mbretin e Aragonit, Napolit dhe Siqilisë një traktat të njohur si "i Gaetës", nga emri i vendit ku u nënshkrua¹⁷.

Traktati u nënshkrua jo vetëm në emër të Skënderbeut, por edhe të "të afërmve të tij baronë në Arbëri"¹⁸. Ky traktat i njëhte Mbretit të Aragonit, Napolit dhe Siqilisë sovranitetin mbi "trojet e të thënit Gjergji" dhe mbi "trojet e Krujës dhe kështjellën", në shkëmbin të ndihmës që Mbreti do t'i jepte atij (Skënderbeut) në luftën kundërosmane. Në termat e traktatit Skënderbeu dhe ajo çfarë mund të quhet "lidhja familjare" e tij shpreheshin të gatshëm të njihnin sovranitetin e mbretit Alfons edhe mbi trojet apo kështjellat e tjera që do të fitonin me ndihmën e tij. Kreu i Lidhjes, Skënderbeu, shprehej i gatshëm të vinte në vendin që do të caktonte Mbreti për t'i bërë atij betimin dhe për t'i shprehur nderimin si vasali sovranit, por mbasi të kishin larguar osmanët me ndihmën e tij¹⁹. Me

¹⁷ ACA, Reg. 2697, fl. 100 verso dhe recto. CERONE: La politica, XXVIII, I, 172-173. RADONIC: Djuradj, nr. 38.

¹⁸ "Capituli inhi et firmati fra la Serma Mtà de lo Sermo Sre Don Alfonso, Re d'Aragona, de Sicilia citra et ultra farum, dal una parte, e lo venerabile patre in Christo domino Stephano, episcopo de Croya, et lo religioso mastro Nicola de Bergugi del ordine de Sancto Domeneco, oraturì et ambassiaturi de lo spectabili et magnifico Georgio Castrioti, Sre dela dita citate de Croya e de soi parenti, baruni in Albania, de la parte altra", po aty.

¹⁹ "Item prometeno et se obligano li dicti ambassiaturi in lo nome predicto a la predicta Mtà lo sucurso e cacciato fora lo dictooo Sr de le mane de li Turchi, lo prefacto Sr Georgio venera personaliter a li piedi de la dicta Mtà douuncha ordenara et li prestara juramento et homagio de fidelita et de vasallagio et farra et exequira quanto per la prefacta Mtà li serra comandato", po aty.

përfundimin e traktatit, krerët abër zotoheshin t'i dërgonin përvit mbretit Alfons, kur osmanët të ishin dëbuar nga Arbëria, një shumë të hollash të barabartë me haraçin që Skënderbeu dhe të afërmit e tij i detyroheshin sulltanit²⁰. Sikurse vihet re, është fjala për një traktat vasaliteti, ndërkohë që Barleti ka ngulmuar ta përshkruajë atë me termat e "miqësisë"; simbas mendësisë së kohës, Barletit duhej t'i dukej "poshtëruese" natyra e vërtetë e këtyre marrëdhënieve juridiko-politike për një figurë si Skënderbeu²¹. Nga ana tjetër, për Marinescu-n kushtet e këtij traktati lënë të kuptohet gjendja e vështirë në të cilën ndodheshin Skënderbeu dhe krerët e tjerë të Lidhjes së Lezhës; madje ai është i mendimit se zotërimet e tyre dhe ato të kreut të tyre, Skënderbeut, ndodheshin në atë kohë në duar të osmanëve²².

Traktate të ngjashme lidhte mbreti Alfons edhe me zotërinj (bujarë) të tjerë arbër, si me Arianitin²³. Madje Araniti, i cili tani shfaqej me titullin "kont i Arbërisë" dhe kishte mëtime mbi Arbërinë e jugut, autorizohet nga mbreti Alfons të merrte në emër të tij betimin e aleancës edhe prej zotërinjve të tjerë arbër²⁴. Si shpërblim mbreti Alfons u lidhte çdonjërit prej vasalëve një pension vjetor prej 300 deri

²⁰ "... cacciati li Turchi de le terre del dicto Sr Georgio, isso Sr Georgio et tucti li soi parenti daranno et pagaranno ciascuno anno a la prefacta Mtà lo tributo o heraci che per li presenti sono tenuti dare a lo Gran Turcho in lo tempo et secondo pagano a lo dicto Turcho", po aty.

²¹ PALL: Barlezio, 91-92.

²² MARINESCU: Alphonse, 44.

²³ Traktati me Arianitin në ACA, Reg. 2691, fl. 101 recto -102 verso. RADONIC: Djuradj, nr.

²⁴ Po aty.

1.4000 dukatesh dhe u premtonte strehim në rast nevojë. Të njëjtat marrëdhënie praktikonte ai edhe me zotërinj moreotë, si me vetë despotin e Moresë²⁵ etj. Një politikë e këtillë dëshmon faktin që kryqëzata e planifikuar prej mbretit Alfons duhej të fillonte nga Arbëria ose nga Morea²⁶. Vë re Marinescu: "Zotërimet dhe forcat e koalicionit familjar të drejtuara prej luftëtarit arbër duhej të përbënin bazën e kësaj ekspedite që do ta bënte mbretin Alfons V zot të pellgut lindor të Mesdheut, siç ishte tanimë i atij të Perëndimit"²⁷. Që nënteksti i këtij traktati kishte të bënte pikërisht me një kryqëzatë të tillë, këtë e ka vënë re edhe Noli kur ka shkruar: "Traktati ishte përfunduar me mendimin [was supposed] për të përgatitur terrenin për një kryqëzatë që Alfonsi kishte projektuar, por që nuk do ta vinte kurrë në jetë"²⁸.

Edhe ndërhyrja pranë Papës nga ana e mbretit Alfons nuk mbeti pa përgjigje. Si u pa, 1450-a ishte për Krishterimin vit jubilar, kur mbas fitoreve të Skënderbeut Nikolla V jo vetëm i dërgoi atij ndihma, por e quajti edhe "Luftëtar të Krishtit" dhe "kampion dhe shqyt i Krishterimit kundër turqve"²⁹. Më 1451 Papa kishte dhënë urdhrin që një pjesë e të hollave të mbledhura nga ndjesat e vitit 1450 t'i jepeshin Skënderbeut; kishte bërë përcaktimet e ndjesave për rajonin në fjalë ndaj gjithë

²⁵ Traktati me despotin Dimitër Paleologu në ACA, Reg. 2697, fl. 98-99.

²⁶ MARINESCU: Alphonse, 44-45, shën.

²⁷ MARINESCU: po aty, 45.

²⁸ NOLI: George, f. 49.

²⁹ KAYSER: Nicholaus, 215-216, shën. 3, appendix nr. 7. CUGNONI: Piccolomini, 100. MAKUŠEV: Raszyskanija, 93.

atyreve që do të mbështesnin Skënderbeun në luftërat kundërosmane; kishte emëruar franceskanin Eugjen Summa (de Somma) "internunc papnor" me autoritet në Arbëri, si dhe në Bullgari, Rashë etj. Në prill 1452 mbreti Alfons përcillte në Romë domenikanin Nikollë de Berguzi, ambasador i një prijësi të quajtur Muzakë dhe prijësish të tjerë arbër. Ai i kishte sjellë Mbretit njoftimin se Pal dhe Nikollë Dukagjini, së toku me disa krerë të tjerë më pak të rëndësishëm, kishin kaluar në anën e osmanëve dhe i qenë kundërvënë Lidhjes së Lezhës. Kësaj radhe mbreti Alfons i lutej Papës të ndërhynte pranë dy Dukagjinëve që të braktisnin "të pafetë" dhe, në rast se nuk bindeshin, ai i sugjeronte Shenjtërisë së Tij t'i shkishëronte³⁰. Këtë ndërhyrje pranë Atit të Shenjtë mbreti Alfons e bënte, sikundër e pohonte vetë, jo vetëm për hir të mbrojtjes së fesë, por edhe se shumë prijës arbër ishin vënë tanimë nën proteksionin e tij³¹. Papa do ta kryente ndërhyrjen e kërkuar më 20 korrik, duke ngarkuar ipeshkvin Pal të Drishut për të bindur Pal dhe Nikollë Dukagjinin se çdo bashkëpunim kundër Skënderbeut do të vinte në fitim të osmanëve, të cilët do ta sulmonin Arbërinë dhe do të rrezikonin kështu fatin e të krishterëve të tjerë³². Përçapja e ipeshkvit duhet të ketë mbetur pa rezultat, përderisa Papa u detyrua t'i shkishëronte dy Dukagjinët³³.

³⁰ ACA, Reg. 2549, fl. 157. MARINESCO: Alphonse, 57, shën 1.

³¹ Po aty.

³² "Venerabili fratri Paulo episcopo Drivastensi A. S. N. et oratori nostro salutem. Intellixemus gravia suscitata esse, et in dies acerbiore fieri inter dilectum filium nobilem virum Georgium Castriot Scanderbegh, ac Paulum et Nicolaum Ducagninos in Albania dominos, que res magna molestia nos afficit, et dolemus maxime ut inter Christianos principes eae dissensiones vigeant, hoc praefertim tempore, in quo nedum deberent vires eorum unitas habere, ut potentiae Teucrorum facilius resistere valerent, verum etiam instante bello aliorum ascictis et convocatis auxiliis omni studio ac diligentia incumbendum est, ne Christiani nominis hostes hanc occasionem nacti, eos invalidos, et ad alia molienda intentos subita excursionem adorti, magna detrimenta non solum ipsis, sed

Në zbatim të traktatit të Gaetës (të 26 marsit) mes mbretit Alfons dhe Skënderbeut regjistrohet një komunikim i dendur. Vetëm më 14 maj Mbreti i Napolit i dërgonte atij tri mesazhe, në të cilat i drejtohej me "I nderueshmi dhe i madhërueshmi besniku ynë i dashur"³⁴, apo me "Burrë i madhërueshëm, besnik yni i dashur"³⁵ etj. Ndërkohë që mbreti Alfons e kishte furnizuar peshkopin e Krujës, në largimin nga oborri i tij, me drithë, salnitër (nitrat potasi) dhe squfur për Skënderbeun³⁶, në fund të majit ai dërgonte në Arbëri oficerin e Zyrës së thesarit Bernard Vaquer me njëqind këmbësorë dhe nozullimet përkatëse. I pajisur edhe me një kopje të vetë traktatit, Vaquer-i duhej të fillonte zbatimin e tij simbas kapitujve të nënshkruar. Mbreti Alfons ia rekomandonte atë Skënderbeut me një shkresë në latinishtë³⁷, ndërsa udhëzimet e veprimeve që do të kryente për

similibus populis inferrent, quod ne eveniat, continuo Deum suppliciter oramus. Et quoniam non possumus malis istis nosmet mederi, deputavimus te mediatorem... etc.". RAYNALDI: Annales, ad annum 1452, nr. 15. PISKO: Skanderbeg, 137-138 (me datimin gabim).

³³ MARINESCO: Alphonse, 57.

³⁴ "Espectabilis et magnifice devote noster dilecte". ACA, Reg. 2658, fl. 149 verso. RADONIC: Djuradj, nr. 42.

³⁵ "Magnifice vir, devote noster dilecte". ACA, Reg. 2658, fol. 149 verso. RADONIC: Djuradj, nr. 43, 44.

³⁶ "E avisara axi mateix lo dit comissari al dit senyor Jordi de part del dit senyor Rey del forment e deu quintas de salnitre e X quintas de sofre quel dit senyor Rey ha manats donar al dit bisbe de Croya per que sien donats de part del dit senyor Rey al dit senyor Jordi". ACA, Reg. 2655, fl. 135 verso. RADONIC: Djuradj, nr. 47.

³⁷ "Spectabilis et magnifice vir, devote noster dilecte! Mittimus in presentiarum ad vos in vestri presidium et defensionem adversus Theucros pro observatione capitulorum, nuper inter nos et oratores vestros initiorum, duos nostros comestabulos cum centum peditibus ac etiam victualia et alia nonnulla, nec non

marrjen në dorëzim të kështjellës dhe qytetit të Krujës i jepeshin Vaquer-it hollësisht me një shkresë të 29 majit në katalanishte³⁸. Mbas marrjes në dorëzim të kështjellës dhe qytetit, me trupën 100 këmbësorësh që sillte me vete komistari i Mbretit do të formonte garnizonin për mbrojtjen e saj, do t'u kërkonte banorëve të qytetit "betimin e besnikërisë", do të fillonte nxjerrjen e taksave etj.³⁹. Me sa duket, për të bashkërenduar frontin e kryqëzatës mbreti Alfons njoftonte edhe Janko Hunyadi-n për

nobilem virum Bernardum Vaquer, commissarium nostrum, ad agendum scilicet et complendum ea, que a nobis virtute capitulorum prefatorum agi et compleri debent...". ACA, Reg. 2655, fl. 133. RADONIC: Djuradj, nr. 45.

³⁸ "E lo dit senyor Rey ha dada al dit Bernat Vaquer plena comisio e potestat de reebre e havre a mans sues, en nom del dit senyor Rey, lo castell e ciutat de Croya, los quals en virtut dels capitols fermats entre la Maiestat del dit senyor Rey de una part e lo bisbe de Croya e maestro Nicola de Berguzi, del orde de Sent Domingo, en nom e per part del dit senyor Jorgi, de la part altra deven esser assignats a la dita Maiestat o a la persona que aquella hi trameta, lo dit comisari demanara e requerra al dit senyor Jordi que li faça assignar los dits castell e ciutat, segons forma dels dits capitols, dels quals lo dit comisari sen porta la copia". ACA, Reg. 2655, fl. 135 verso. RADONIC: Djuradj, nr. 47.

³⁹ "E si lo dit senyor Jordi, segons creu lo dit senyor Rey, assignara, com tengut es, los dits castell e ciutat al dit commissari, de continent reebra homenatges dels ciutadans de aquella en nom e per part del dit senyor Rey e ordenara los officials en aquella en nom del dit senyor e metra en lo castell los companyons necessaris a la guardia e defensio de aquell, e exigira los drets pertanyents al senyor en aquella e los altres drets e entrades que segons forma dels capitols en son cas e loch pertanyeran al dit senyor Rey...", po aty.

dërgimin e komisarit pranë Skënderbeut⁴⁰. Studiuesi i marrëdhënieve të mbretit Alfons me Skënderbeun ka shënuar për këtë moment: "Duke filluar prej muajit qershor 1451 Kruja, me të cilën qëndresa e Skënderbeut ishte lidhur gjithmonë deri këtu, nuk do t'i përkiste më luftëtarit arbër. Për vite me radhë një garnizon napolitan i komanduar prej katalanësh do të vendoset në këtë "fole shqiponjash" të Arbërisë, ndërsa Kastrioti do të vijojë jashtë saj luftën që e ka bërë të famshëm"⁴¹.

Në maj 1452 mbreti Alfons dërgonte në Arbëri si guvernator të Krujës, ish-kryevendi i Skënderbeut, kalorësin katalan Ramon d'Ortafá në rangun "nënmbret në Arbëri". Detyrat e tij, të përcaktuara më udhëzimet e 23, 24, 25 dhe 26 prillit, ishin: të mbikëqyrte sigurinë e qytetit dhe ruajtjen e "fesë së Krishtit" mes popullsisë (me sa dukej nga islamizmi që kishte filluar të depërtonte), të përpiqej të shtinte rish në dorë viset e marra prej osmanëve dhe, po të ishte e mundur, të fitonte territore të reja⁴². Komandant i ri në kështjellë emërohej një katalan i quajtur Pere Scuder, që zëvendësonte kështjellarin e mëparshëm Juan de Castro; guvernatori i ri sillte me vete si armë dhe municione, ashtu edhe drithëra dhe verëra⁴³. Skënderbeut si vasal i sillej dhuratë simbolike një cohë e qëndisur në flori dhe njëzet copë pëlhura ngjyrash të ndryshme⁴⁴. Po ta dëgjojmë edhe një herë Marinescu-n,

⁴⁰ "Mittimus in presentiarum in partes istas Albaniae duos nostros contestabulos cum centum peditibus in presidium et adiutorium spectabilis et magnifici Georgii Castrioti, domini Croye, adversus Teucros, cum quibus proficiscitur commissarius noster Bernardus Vaquer. Rogamus et precamur vos... etc.". ACA, Reg. 2655, fl. 134 verso. RADONIC: Djuradj, nr. 46.

⁴¹ MARINESCO: Alphonse, 48.

⁴² ACA, Reg. 2660, fl. 21, 21 verso, 22, 22 verso, 24 verso. RADONIC: Djuradj, nr. 52, 53, 54, 55, 56.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ MINIERI-RICCIO: Alcuni fatti, vëll. IV, fash. III, f. 418.

ai ka dalë në këtë përfundim: "Duke filluar prej këtij momenti deri më 1458 të gjithë fitoret që deri më tani i janë atribuar vetëm Skënderbeut, duhen llogaritur të arritura gjithmonë me ndihmën e mbretit të Napolit"⁴⁵.

Në shtator 1452 Skënderbeu, në bashkëpunim me forcat napolitane, mundte dy komandantë osmanë në kufirin me Maqedoninë⁴⁶. Por, në përgjithësi, për vitin 1452 mund të thuhet se Arbëria u la në qetësi. Madje, duke përjashtuar ndonjë ndeshje pa rëndësi të madhe në kufijtë e Arbërisë, duket se Skënderbeu ia doli të merrte në këtë vit edhe territore të tjera⁴⁷. Sulltan Mehmeti II, në të vërtetë, ishte në gatitje e sipër për fushatën përfundimtare kundër Kostandinopojës. Ndërsa luftërat e brendshme në Arbëri, përkundrazi, duket të qenë acaruar. Në mars 1453 mbreti Alfons bënte një ankesë pranë dogjës së Venedikut, duke i kujtuar se, me pagën që Republika kishte nënshkruar me Skënderbeun më 1448, kishte marrë përsipër jo vetëm t'i paguante atij një pensison të përvitshëm prej 1.400 dukatesh, por edhe ta ndihmonte duke mos lejuar depërtimin e rebelëve në zotërimet e tij. Nëse deri më 1452 stipulimet e traktatit në fjalë kishin qenë respektuar, tani Republika jo vetëm nuk ia paguante Skënderbeut pensionin, por edhe mbante krahun e Dukagjinëve në luftën që ata i bënin Skënderbeut. Si sovran i Skënderbeut, mbreti Alfons i lutej dogjës së Venedikut të vijonte t'i paguante vasalit të tij pensionin e caktuar dhe të mos përkrahte më Dukagjinët. Me sa kuptohet nga zhvillimi i ngjarjeve, edhe për vitin 1453 konflikti me Dukagjinët, si "kanakarë" të Republikës, do të vijonte. Vetëm rënia e Kostandinopojës, duke i cenuar rëndshëm interesat venedikas në Lindje, do ta

⁴⁵ MARINESCO: Alphonse, 61.

⁴⁶ FALLMERAYER: Griechenland, IX, 55-56. PISKO: Skanderbeg, 139. Por që të dy varen te BARLETTI.

⁴⁷ PISKO: Skanderbeg, 65-66. JORGA: Notes, II, 485.

detyronte Republikën "ta kthente" politikën ndaj osmanëve dhe, si rrjedhim, edhe politikën e saj në Arbëri.

Rënia zhurmëmadhe e kryeqytetit perandorak më 29 qershor 1453 do ta shkundte mbarë Europën⁴⁸. Në Romë lajmi i rënies së Kostandinopojës mbërriti më 8 korrik; pak më vonë kardinali Isidor, që i kishte shpëtuar për mrekulli masakrës në Kostandinopojë dhe ia kishte dalë të arratisëj në Kandi (Kretë), hartoi së andejmi për Papën një relacion tronditës mbi katastrofën⁴⁹. Po të lexohen faqet përkatëse në veprën klasike të baronit Ludwig von Pastor, Historia e papëve, 1453-shi shfaqet i përshkruar si vit tronditjeje të madhe për Perëndimin, posaçërisht për Romën: "Tmerrit që lajmi hapi në Romë iu shtua menjëherë frika, mbasi lajme të mëtejshme bënë me dije se të pafetë kishin shtënë në dorë anijet papnore dhe se turqit po pajiseshin me një flotë prej 300 anijesh për t'i gatitur edhe Romës së vjetër fatin që kishte pësuar e reja. Të gjitha lajmet përputheshin me këtë, sa përshtypja që bëri mbi Papën dhe mbi kardinalët lajmi i rënies së Kostandinopojës ishte përnjëmend dërrmuese. U ndie në mënyrën më të thellë që humbja e bastionit të fundit të Krishterimit në Lindje ishte një ngjarje botërore e cila do të sillte rrjedhoja shumë të rënda"⁵⁰. Edhe me kalimin e valës së parë të tronditjes, e vërteta që mbetej ishte se me rënien e Kostandinopojës një krizë e re ndërkallej në historinë e botës; Mordtmann-i vinte re me të drejtë se jehona e jashtëzakonshme e kësaj ngjarjeje dëftonte se si Kostandinopoja kundërpeshonte vende dhe krahina të tëra⁵¹. Jo më kot viti 1453 do të

⁴⁸ Për rënien e Kostandinopojës më gjerë MORDTMANN: Belagerung. FINLAY: History. VLASTO: Les derniers. PASTOR: Geschichte, 611-616.

⁴⁹ E ka botuar JORGA: Notes, II, 522 edhe vij.

⁵⁰ PASTOR: Geschichte, I, 613.

⁵¹ MORDTMANN: Belagerung, 2. PASTOR: Geschichte, 611, shën. 1.

mbahej si kufiri që ndan Mesjetën nga Koha e re. Gati njëzëshëm historishkruesit e kontinentit janë të një mendimi mbi faktin që rënia e Kostandinopojës do të ndikonte në krijimin e një koncepti të ri mbi Europën, posaçërisht në raportin Lindje/Perëndim.

Leonardo de' Benvoglianti, i dërguar nga Siena në Venedik për të takuar kardinalin Isidor të mbërritur aty, njoftonte lajme edhe më pesimiste. Kardinali Isidor tregonte gjëra të padëgjueshme ndonjëherë mbi egërsinë e osmanëve, por sidomos dëshmonte idenë e tyre të ngulmët për të mbërritur Romën dhe "shkatërruar" Italinë. Rreziku, simbas kardinalit Isidor, ishte i pamatshëm, dhe nevojitej në mënyrë të domosdoshme "bashkimi i të krishterëve"⁵². Me një sens tejmasë realist, kardinali vinte në dukje se fuqia e Sulltanit i dukej më i madhe nga ajo që kishte pasur ndonjëherë në dorë ndonjë pushtues, një Qesar ose një Aleksandër; ai vinte në dukje faktin që sulltan Mehmeti kishte në dorë mjete të madha financiare, një flotë 230 anijesh, një kalorësi 30.000 vetësh, ndërsa numrin e këmbësorëve mund ta shtonte në pamarim. Po simbas tij, "të pafetë" mund të vërshonin në Italia nga Kalabria; sikurse De' Benvoglianti relatonte, kardinali ishte i bindur që, po që se për gjashtë muaj nuk vendosej paqja mes fuqive italiane në grindje mes syresh, atëherë brenda tetëmbëdhjetë muajsh osmanët do të ishin në Itali⁵³.

Veprimi i parë i Papës si udhëheqës tradicional i kryqëzatave, mbas kalimit të valës së parë të tronditjes, ishte dërgimi i legatëve papnorë pranë fuqive italiane për t'u kërkuar të bënin paqe: mbreti Alfons me Gjenovën dhe Firencën, si dhe këto me mbretin Alfons; Venediku me Dukatin e Milanos

⁵² Relation i datës 2 nëntor 1453. ASS, ad annum 1453. PASTOR: Geschichte, I, 625, shën. 4; 626, shën. 2. Edhe PIERLING: La Russie, I, 78 dhe vij.

⁵³ Letër e Ennea Silvio PICCOLOMINI-t te PASTOR: Geschichte, I, 615, shën. 2.

dhe ky i fundit me Republikën etj. Në Romë u krijua një kongregatë kardinalësh që duhej të studionte mjetet dhe rrugët për t'i bërë ballë rrezikun osman⁵⁴. Edhe perandori Frederik III ndërhyri pranë Papës duke i bërë thirrje të ndikonte në pajtimin e shteteve të kishtera, të thërriste në një kuvend princërit e krishterë që "të rroknin armët kundër armikut të kryqit", si dhe shprehej i gatshëm "të mos i bënte bisht detyrës" në kryqëzatën që do të organizohej⁵⁵.

Përpjekjet e Papës si për vendosjen e paqes, ashtu dhe për kryqëzatën, i mbështeti posaçërisht mbreti Alfons, madje duke i dërguar Nikollës V edhe projektin konkret për kryqëzatën. Simbas projektit të mbretit Alfons, osmanët do të sulmoheshin nga fronti hungarez me ndihmën e kalorësve gjermanë. Venediku, nga ana e tij, do të fortifikonte zotërimet e veta në kufi me osmanët. Papa duhej të

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ "Sane pro tanto et tam necessario opere optimum factu cesemus clementiam vestram, quae locum tenet in terris Salvatoris nostri Jesu Christi, cujus res agitur, nunc excurgere, scribere Regibus, legatos mittere, monere, hortari principes ac communitates in aliquem locum, ut aut veniant aut mittant: nunc, dum malum est recens, Christianae rei consulere festinent, pacem aut inducias inter socios fidei componant, atque junctis viribus adversus salutiferae crucis inimicos arma promoveant, Quod si vestra sanctitas toto pectore suoque more, ad rem hanc tam piam et utilem intenderit, non est nobis dubium quin plures et reges et principes, in quibus, zelus domus Dei, et ardor fidei orthodoxae non est extinctus, ad mandatum vestrum voluntarios et obsequentes se praebeant. Nos certè pietati vestrae ut libuerit et assistere et cooperari pro nostri officii debito minime omitteremus. Solum precamur, ut vestrum in hoc negotio consilium et intentum communicaredignemini; namque si fuerit opus nostrae rationis et imperii sacri principes ad hoc ipsum convocare, et alia, quae juxta consilium vestrum putaverimus opportune implere, non negligemus... etc.". RAYNALDI: Annales, XVIII, ad annum 1453, nr. 8.

mendonte posaçërisht për Skënderbeun, i cili, me gjithë ndihmat që mbreti i dërgonte, nuk mund t'u bënte ballë për një kohë të gjatë ushtrive të mëdha osmane të cilat, deri në atë kohë, kishte mundur t'i mbante në kufijtë e zotërimit të tij. Mbreti Alfons ishte i bindur që, por të thyhej ledhi arbëror, sulltani do të mbërrinte me lehtësi nga njëri breg i Adriatikut në tjetrin. Për të ruajtur pra Adriatikut, Papa duhej të ndihmonte Skënderbeun me 1.000 mijë këmbësorë, ndërsa ish-despotin e artës, Leonardin III Tocco, me 3.000 dukate si masë e parë⁵⁶.

Më 30 shtator të atij viti Nikolla V nxirrte një bullë, që fillonte me një "Etsi Ecclesia Christi", me anë të cilës e ftonte gjithë Krishterimin të bashkohej kundër rrezikut Islam duke formuar një bllok kundërosman⁵⁷. Që një bullë që do të bëhej historike; e quajten edhe "bulla kryqtare", ngase bënte thirrje për kryqëzatë. Si njëherë e një kohë, çdo luftëtar në luftën kundër osmanëve duhej të lidhte në sup shenjën e kryqit. Stili i kësaj bulle ishte ndër më të lartët të dëguar ndonjëherë: në të sulltan Mehmeti paraqitej si pararendësi i Antikrishtit dhe krahasohej me dragoin e kuq të Apokalipsit të Gjonit që del nga deti, që ka shtatë koka dhe mbi çdonjëren shtatë diadema dhe dhjetë brirë etj. Në këtë bullë u bëhej thirrje gjithë princërve të Krishterimit të merrnin pjesë në kryqëzatë me pasuritë e tyre, si dhe me gjakun e tyre⁵⁸. Simbas saj, përfitonin "ndjesë plotore" të gjithë ata që, prej 1 shkurtit të vitit të ardhshëm (1454) për gjashtë muaj, ose merrnin pjesë personalisht në "luftën e shenjtë" ose

⁵⁶ ACA, Reg. 2700, fl. 39-40. MARINESCO: Alphonse, 70, shën. 2.

⁵⁷ RAYNALDI: Annales, XVIII, ad annum 1453, nr. 9-11. ZINKEISEN: Geschichte, II, 42. GEORGIUS: Vita, 139. Bullën e analizojnë edhe VOIGT: Piccolomini, II, 95-96; PASTOR: Geschichte, I, 599. Mbi predikuesit e kryqëzatës të dërguar nga papa më gjerë te WADDING: Annales, ad annum 1453; GEORGIUS: po aty, 141 dhe vij.

⁵⁸ Po aty.

jepnin një njeri për këtë luftë. Kisha angazhohej të ndihmonte duke mbledhur fondet për kryqëzatën. Dhoma apostullore do të caktonte për këtë të gjitha "të hyrat e vogla dhe të mëdha", të arkipeshkvive, ipeshkvive, abacive dhe kuvendeve. Kardinalët duhej të dorëzonin të dhjetat e hyrjeve të tyre tërësore. Të gjithë nëpunësit e oborrit papnor, deri në shkallët më të ulta, duhej t'i nënshtroheshin të njëjtës taksë. Për gjithë Krishterimin vendosej një "e dhjetë" e përgjithshme. Kush kundërshtonte, ndëshkohej me shkishërim. Ndëshkime të rrepta caktoheshin edhe për ata që ndihmonin "të pafetë" me armë, municione lufte ose nozullime ushqimore⁵⁹. Nikolla V, "padron i arteve dhe i artistëve", madje shëndetlig dhe në prag të vdekjes, dukej krejt i paaftë për një tekst të tillë. Babingeri është i mendimit se mbrapa kësaj bulle fshihej një prej vartësve të tij më të dijshëm në atë kohë: ipeshkvi i Sienës Enea Silvio Piccolomini, këshilltar dhe sekretar i Perandorit Frederik III. Ky i fundit ishte atëherë ndoshta monarku më i kthjellët i kontinentit, që e kishte veguar më qartë nga të tjerët rrezikun që Europës i kërcënohej⁶⁰. "Sa mirë do të ishte sikur ne të donim e t'i drejtonim trupat tona dhe armët tona kundër armiqve të besimit tonë! Unë s'do të dija vërtet se kujt më shumë se Shenjtërisë Suaj do t'ia takonte kjo, At i Shenjtë!" i shkruante ai Nikollës V më 12 korrik 1453⁶¹.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Nga tregimet e kohës del se, kur mori vesh lajmin e rënies së kryeqytetit në duart e osmanëve, Frederiku III u shkreh në vaj, u tërhoq në dhomat dhe e tij dhe kaloi disa ditë në zi, duke u lutur dhe duke shkruar. Piccolomini, që ishte njeriu i tij më i afërt, e ka pasë përshkruar në kujtimet e veta në mënyrë emocionuese këtë situatë. Nxitësi për nismën e bullës kryqtare ka gjasa të ishte Piccolomini, i cili ishte në gjendje të ndikonte si mbi Perandorin për ta bërë "kampion të botës së krishterë", ashtu edhe mbi papën e plogësht për t'i vënë atij në dorë flamurin e "prijësit të epërm shpirtëror".

⁶¹ PICCOLOMINI: Opera, letra 127.

Ka rëndësi përfshirja e kardinalit Piccolomini në këtë mes, jo vetëm ngase ai më vonë do të rishtaqet si papa Piu II, por për lidhjet specifike që vendoste me Skënderbeun. Historianët e papëve, nga ana e tyre, janë të mendimit se në redaktimin e bullës kishte ndikuar kardinali Francesco Barbaro, një ndër prelatët romanë më të zellshëm për domosdoshmërinë e luftës kundërosmane⁶².

1453-shi është edhe vit i një vizite "gati të fshehtë" të Skënderbeut në Romë dhe Napoli, e cila duket se i ka shpëtuar edhe syrit të vetë Barletit. Pikësëpari, me ndryshimin e politikës së saj lindore, në shtator 1453 Republika e Venedikut i kishte përtëritur klauzat e traktatit me Skënderbeun; prej një dokumenti të 9 tetorit 1453 mësohet se senati i Republikës ka porositur Pietro Marcello-n, proveditor në Lezhë, të shoqëronte Skënderbeun në një vizitë në Romë dhe Napoli simbas kërkesës së këtij⁶³. E përmend këtë udhëtim edhe Halkokondyli, por pa e saktësuar kohën⁶⁴, sikurse e kanë shënuar atë edhe Hopf-i⁶⁵, Marinescu⁶⁶, Pall-i⁶⁷, Noli⁶⁸. Ndërsa Anonimi Raguzan dhe Ragnina flasin për kthimin e Skënderbeut, i cili vinte nga Puglia, nëpërmjet Raguzës⁶⁹.

⁶² AGOSTINI: Notizie, II, 108. PASTOR: Geschichte, I, 615 shën 3.

⁶³ "Ad partem autem, qua scribitis de deliberatione vestra eundi Romam et Neapolim et petitis quod licenciam concedamus nobili viro Petro Marcello, provisorio nostro Alexii, veniendi vobiscum, licet non sit de more nostro concedendi, quod rectores nostri a regiminibus suis discedunt, attamen ut magnificencie vestre complacemus, iussimus dicto nostro provisorio quod cum megnificencia vestra venire debeat". ASV, Senato Deliberazioni da Mar, V, fl. 8. LJUBIC: Listine, X, nr. XXV. RADONIC: Djuradj, nr. 72.

⁶⁴ CHALCOCONDYLAS: Historiarum, VIII, 432-433.

⁶⁵ HOPF: Griechenland, 125.

⁶⁶ MARINESCU: Alphonse, 67 dhe shën 2. ⁶⁴ CHALCOCONDYLAS: Historiarum, VIII, 432-433.

Gjatë kësaj vizite në oborrin e Napolit duket se është biseduar plani i fushatës për Beratin, sikundër mendon Noli⁷⁰, por me siguri edhe aspekte ushtarake të kryqëzatës së pritshme, si do të kuptohet nga projekti për organizmin e kryqëzatës që mbreti Alfons do t'ia paraqiste Papës në kuvendin e 1453-1454-s⁷¹. Nga ana tjetër, në oborrin papnor është diskutuar, pa dyshim, projekti i kryqëzatës së parashikuar nga "bulla kryqtare" dhe i hartuar nga mbreti Alfons. Duket kjo si një ndërkohë e shkurtër përparimesh për Skënderbeun. Nga fundi i nëntorit, nëpërmjet kapelanit të krujës Ilia, ai e njoftonte mbretin Alfons se kishte shtënë në dorë një territor të ri dhe një kështjellë⁷². Në përgjigjen e tij të 7 dhjetorit sovrani e siguronte vasalin se nënmbreti Ramon d'Ortafa do të kthente së shpejti pranë tij për të vijuar luftën kundër osmanëve "sot më shumë se kurrë"⁷³, ndërsa kështjellarit të

⁶⁷ PALL: Barlezio, 85-86 shën. 6.

⁶⁸ NOLI: George, f. 50-51, 203 shën. 41.

⁶⁹ Në Annales Ragusini, ad annum 1453, 62. RAGNINA: po aty, 259.

⁷⁰ NOLI: George, 50-51.

⁷¹ MARINESCO: Alphonse, 69-79. PALL: Skanderbeg, f. 15.

⁷² "Per Don Elya, capellano nostro et home vestro, havemo receputa vostra letra, de la quale havemo havuta piacere assai e maximo essendo stati advisati de lo paese e castello per voi presi...". ACA, Reg. 2660, fl. 48. RADONIC: Djuradj, nr. 74.

⁷³ "Et non dubitate, che presto spacciarimo meser Raimundo d'Ortafa, nostro visere, in quesse parti, advisandove que hogi piu che may havemo volunta in quessa impresa non minore che en lo impresse che facemo decqua", po aty.

Krujës, katalanit Pere Scuder, i premtonte në një mesazh katalanisht ndihma dhe nozullime me rastin e kthimit të nënmbretit⁷⁴.

Ishte koha kur predikuesit e kryqëzatës rrihnin Perëndimin duke nxitur dhe thirrur prijës dhe popuj që të ngriheshin në këmbë dhe "të rroknin kryqin". Ata volën "të dhjetën turke" dhe shpërndanë sa mundën ndjesa, por rezultatet nuk qenë kushedi çfarë. "Zelli për fenë, që dikur pati ngazëllyer turma pa fund në luftën për Varrin e Shenjtë, ishte fikur, - vëren historiani i papëve: - më kot dha e mori Papati që ta ngjallte së rishti"⁷⁵. Në diskutimet e kuvendit të Romës, organizuar prej Nikollës V, që u zhvillua nga vjeshta e 1453-shit në pranverën e 1454-s, asnjëra nga Fuqitë perëndimore nuk u ngrit parimisht kundër nevojës së "kryqëzatës", por ndihmat e ofruara prej tyre ishin të pakta. Ndërsa kardinalë si Barabaro apo ipeshkvij si Piccolomini përfaqësonin në këto rrethana krahun i cili mendonte se Papa ende nuk po bënte sa duhej për organizimin e kryqëzatës, nga krahu i mbrojtësve të Papës kardinali Carvajal i shkruante Piccolomini-t në fund të vitit 1553: "Nëse i ke dëgjuar fjalimet e legatëve dërguar Perandorit, nëse e ke lexuar bullën papnore, nëse llogarit se sa ka bërë Ati i Shenjtë në mbrojtje të Krishterimit, kurrfarë qortimi nuk do t'i bësh. S'ka pasur ende një papë që të ketë qenë aq i dhënë mbas së mirës së përbashkët sa Nikolla V. Dhe zelli i tij, në këtë mes, nuk ka të biseduar. Kështu ai i dhuroi 5 mijë dukate Skënderbeut dhe i premtoi ndihmë të mëtejshme që ai të mund të mbrohet nga turqit; i dërgoi 60 mijë dukate ishullit të Rodit; shpenzoi 4 mijë dukate për të

⁷⁴ "Mas stan de bona voluntad car prest desenpaharem lo magnífich mossen Ramon de Ortaffa, visrey nostres en aqueixes parts e us provehirem de lo que haven necesari". ACA, Reg. 2661, fl. 48. RADONIC: Djuradj, nr. 73.

⁷⁵ PASTOR: Geschichte, I, 617.

pajisur flotën luftarake për t'u dërguar kundër turqve; me një shumë të paqme u orvat të nxiste prijësin e Karamanies të sulmonte osmanët; me frymë të madhe flijimi u përpoq të armatoste për mbrojtjen e Krishterimit popullsinë e Trebisondës, Arbërisë, Dalmacisë dhe të vendeve të tjera pranë turqve"⁷⁶. Më 1 janar 1454 Piccolomi do t'i përgjigjej duke i shkruar, mes të tjerave: "Por kjo s'mjafton: E ç'mund të bëjnë vallë pesë trirremshe tuajat kundër turqve? Ç'janë pesëmijë [dukate], që të tjerë thonë trimijë, dhënë Skënderbeut?"⁷⁷. Me interes duket fakti që, edhe nga një informacion që Sceva de Curte i dërgonte dukës së Milanos për Skëndebeun më 22 shkurt 1454, do të flitet pikërisht për 3.000 dukate dhënë nga ana e Papës, jo për 5.000: "Papa i dërgoi [Skënderbeut] dukate trimijë, të gjitha venedikase, me njëmijë siguri për mbështetje e premtime etj. dhe u numëruan të gjitha në flori"⁷⁸.

Me kalimin e kohës ajo çfarë u pa ishte se, në rastin e një kryqëzate për të cilën flitej dhe punohej, forcave që qëndronin dhe luftonin në Europën jug-lindore do t'u mbetej të mbështeteshin vetëm mbi elementët vendorë. Skënderbeut në këtë kohë i vinin thujse vetëm ndihmat konkrete të sovranit të tij: mbretit Alfons.

Në fillim të vitit 1454 si Skënderbeu ashtu dhe rektorët e Republikës e lajmëronin Mbretin e Aragonës, Napolit dhe Siqilisë se osmanët po gatitnin një ekspeditë kundër Arbërisë dhe zotërimeve të Venedikut në Arbëri. Republika vendosi që oficerët e saj të bashkonin forcat e tyre me ato të

⁷⁶ PASTOR: po aty, 616.

⁷⁷ CUGNONI: Piccolomini, nr. 34.

⁷⁸ "El papa li ha mandati ducati tria milia, tuti venetiani, cum mille conforti et promesse etc. e sono stati tuti numerati in oro". ASM, Carteggio gen. Sforzasco, ad annum 1454. RADONIC: Djuradj, nr. 76.

Skënderbeut për t'u bërë ballë më mirë "të pafeve"⁷⁹. Nga ana e tij, Skënderbeu iu drejtua për ndihmë si sovranit të vet, mbretit Alfons, ashtu edhe Papës. Me anë të ambasadorit të tij Pal Gazulli duket se të dy palët, edhe Mbreti edhe Papa, i dërguan ndihma⁸⁰. Nga sa një Sceva de Curte i relatonte Dukës së Milanos, Papa i kishte dërguar 3.000 dukate, ndërsa mbreti Alfons 500 këmbësorë dhe një shumë të hollash⁸¹. Mesazhi i mbretit Alfons, i datës 29 mars 1454, fillonte me: "I mrekullueshmi dhe i pamposhturi burrë Gjergj Kastrioti, kapiten i madhërueshëm njerëzish të armatosur, i shumëdashuri ynë"⁸². Ndërsa Republika e Venedikut, nga ana e saj, gjente një "zgjidhje" tjetër: në prill 1454 ajo ia delte të lidhte me sultan Mehmetin një traktat për të ruajtur interesat e vet tregtarë. Sikurse e kanë

⁷⁹ "Et sicut omnes intelligunt conservationi status nostri in Albania nulla alia securior neque melior provisio fieri possit, quan ordinare quod nostri rectores talem intelligentiam capiant cum dicto Scanderbego, quod amnes gentes et vires Albanie colligantur in unum ad oppositum Teucris; vadit pars, quod ad literas Scanderbegi respondeatur in illa forma etc.". ASV, Senato Deliberazioni da Mar, V, fl. 19. LJUBIC: Listine, X, nr. XXXIII. RADONIC: Djuradj, nr. 75.

⁸⁰ "Per meser Paulo de Gazulo havemo receputa vostra lettera, la quale ha multo bene sollicitato lo soccorrimento de quesse bande dalla, havemo comandato al dicto messer Paulo che sende debia andare ad vuy con lo soccorrimento, che ve fa nostro signiore lo papa etc.". ACA, Reg. 2799, fl. CVIII. RADONIC: Djuradj, nr. 77.

⁸¹ "È stato qua lo suo ambascadore per aiuto. Lo re d'Aragona li ha mandati V cento fanti et alcuni pochi denari, e dicese chel s'è facto raccomandato de esso re d'Aragona, ma de ciò, id est de la raccomandatione, non sapemo lo certo". ASM, Carteggio gen. Sforzasco, ad annum 1454. RADONIC: Djuradj, nr. 76.

⁸² "Magnifico et strenuo viro Georgio castrioti, dicto Scandabech, gentium armorum magnanimo capitaneo, nobis plurimum dilecto", po aty.

pohuar njëri mbas tjetrit Pastor-i, Jorga, Marinescu: Republika e Shën Markut u bë kështu e para fuqi e Perëndimit që, pa marrë parasysh solidarësinë e krishterë, rivendoste marrëdhëniet diplomatike dhe tregtare me Perandorinë e re bizantine të trajtës osmane⁸³.

Më 14 qershor të atij viti regjistrohet kthimi në Krujë i nënmbretit Ramon d'Ortafà, që kishte munguar për disa kohë. Nënmbreti vinte tanimë me rekomadimet e Mbretit për Skënderbeun, por edhe për Gojko Stresin, Ivan Strezin, Gjijn Muzakën, Muzak Topian dhe një Aranit me emër të palexueshëm mirë në dokument⁸⁴. Vihet se se në letrën kredenciale përkatëse të mbretit Alfons Skënderbeu thirret përsëri, po ashtu si më 29 mars, me titullin e ri: "Kapiten i përgjithshëm i njerëzve tanë të armatosur në viset e Arëbërisë"⁸⁵. Nga sa kuptohet prej kësaj letre, tani Ramon d'Ortafà-së i jepej një autoritet edhe më i madh: ai ngarkohej për të ndihmuar "bestarët e Krishtit" jo vetëm në Arbëri, por edhe në "Sklavoni"⁸⁶ dhe Greqi⁸⁷. Misioni i Ramon d'Ortafà-së, njëherësh politik dhe

⁸³ PASTOR: Geschichte, I, 603-604. JORGA: Geschichte des Osmanische, II, 46. MARINESCO: Alphonse, 76.

⁸⁴ "Similes litere fuerunt expedite directe sequentibus: Magnifico viro Georgio Strezi, consiliario, fideli nobis dilecto; Magnifico viro Yvan Strezi, consiliario, fideli nobis dilecto; Magnifico viro Gin Musaych, consiliario, fideli nobis dilecto; Magnifico viro Musaych Thopia, consiliario, fideli nobis dilecto; Magnifico viro [emri nuk lexohet] Arent, consiliario, fideli nobis dilecto". ACA, Reg. 2799, fl. CXV verso. RADONIC: Djuradj, nr. 79.

⁸⁵ "Magnifico et strenuo viro Georgio Castrioti, dicto Scandarbec, gentium armorum nostrarum in partibus Albanie generali capitaneo, consiliario fideli nobis dilecto", po aty.

⁸⁶ Simbas mendimit të MARINESCO-s, termi "Sclavonia" ka të bëjë me Dalmacinë dhe posaçërisht me viset e Vukcicit, Alphonse, 78.

fetar, lë të nënkuptohet se në zonat e dyndjes osmane kishte filluar një proces braktisjeje të krishterizmit dhe përqafimi të Islamit. Njëherësh me nënmbretin, mbreti Alfons dërgonte në Arbëri një Fra Lorenzo da Palerino dhe një Fra Giovanni dell'Aquila me nga një flamur taftaje me kryq të bardhë qëndisur në mes si simbol i kryqëzatës që po fillonte⁸⁷: të gjitha simbole të qarta se lufta do të bëhej në emër të Alfonsit, si sovran dhe zotërues i atij rajoni. Çfarë duket edhe më me rëndësi, tani nënmbretit i jepej edhe autorizimi për të prerë monedha në Krujë, me të njëjtën peshë dhe të njëjtën datë të atyre që priteshin në të njëjtën kohë në Napoli⁸⁹. Sovraniteti i Mbretit të Aragonës, Napolit

⁸⁷ "... et statum Christi fidelium provinciarum Grece, Albanie et Sclavonie CERONE earumve pertinentiarum et districtuum, que damnatorum Christi rebellium Teucrorum sepenumero temptantur circumvallantur et occupantur insultibus, aggressionibus et insidiis quampluribus, ut que ex dictis provinciis restant possint Christique fideles in eis degentes occupare et ad dampnabilem eorum sectam in vituperium religionis cristiane juxta eorum sectam pravum propositum reducere pro Dei zelo"; "... ad dictas provincias Grece, Albanie et Sclavonie earumque pertinentias et districtus personaliter conferre debeatis et cum inibi fueritis sic pro Dei zelo nostroque honore ac servitio circa bonum refimen et prosperum statum dictorum Christi fidelium dictarum provinciarum earumque civitatum, terrarum, castrorum et incolarum". ACA, Reg. 2661, fl. 70 verso- 71 recto. RADONIC: Djurad, nr. 80.

⁸⁸ MINIERI-RICCIO: Alcuni fatti, IV, III, 418 (me datën gabim): La politica, XXVII, 775 (me datë gabim). JORGA: Geschichte des Osmanischen, II, 46 (e jep mbas 15 korrikut 1454). MARINESCO: Alphonse, 82.

⁸⁹ ACA, Reg. 2799, fl. 114 verso -115. PISKO: Scanderbeg, 67, e interpreton gabim sikur ishte Skënderbeu që i kishte lejuar mbretit Alfons të priste monedha në Krujë; gabimin e ka nga SUMMONTE: Historia, II; e qorton gabimin MARINESCO: Alphonse, 81 shën. 2.

dhe Siqilisë edhe mbi zotërimet e Skënderbeut dhe "baronëve të tjerë të Arbërisë" bëhej kësisoj i plotë: nga flamujt aragonezë te prerja e monedhave napolitane.

Nën ndikimin e mbretit Alfons, edhe Papa vijonte përpjekjet për të ndihmuar Skënderbeun, posaçërisht duke e funksionalizuar atë brenda koalicionit të krishterë⁹⁰. Në fillim të vitit 1454 Papa ndërhynte përsëri në konfliktin mes Dukagjinëve dhe Skënderbeut, i cili rrezikonte të degjeneronte në luftë civile, mbasi me rënien e Kostandiopojës Dukagjinët kishin bërë paqe me osmanët. Duke e përfillur këtë fakt "në dëm të çështjes së krishterë"⁹¹, me mesazhin e 22 gushtit 1454 Papa lëshonte një interdict që i shtrengonte Dukagjinët ta prishnin paqen me osmanët dhe të pajtoheshin me Skënderbeun; pajtimin duhej ta shoqëronin me një "betim fetar" për të cilin ngarkoheshin dy ipeshkvijtë: ai i Lezhës dhe ai i Pultit⁹². Në tetor të atij viti edhe mbreti Alfons bënte një ndërhyrje pranë Dukagjinëve. Atë muaj një i dërguar i Nikollë Dukagjinit (Pal Dukagjini ndërkohë kishte vdekur) me emrin "Brexanus" [Breçani?] bënte vizitë në oborrin e tij dhe mbreti Alfons ia rekomandonte atë Papës për t'i dhënë "zgjidhjen nga mëkati" zotërisë së tij për betimin e bërë me rastin e paqes me osmanët⁹³. Mbreti Alfons i lidhte edhe Nikollë Dukagjinit një pension vjetor prej

⁹⁰ KAYSER: Nicholas, 215.

⁹¹ "... et aliis in detrimentum Christianorum per eos hactenus attemptatis hujusmodi deinceps se penitus absistere, necnon cum eodem Georgio concordiam inierint et invicem reconciliati existant". THEINER: Monumenta Slav, I, 413-414. HOPF: Griechenland, II, 133.

⁹² Po aty.

⁹³ MARINESCO: Alphonse, 84.

300 dukatesh, që do të nxirreshin prej të ardhurave të kripës në Arbëri⁹⁴; për këtë "rregullim" ai njoftonte më 21 tetor si Pal Dukagjinin, ashtu edhe Skënderbeun⁹⁵.

Në Kuvendin e Romës në dhjetor 1454 mbreti Alfons i parashtroi Papës një "përkujtesë" (memoriale), për sipërmarrjen kundërosmane⁹⁶. Simbas këtij projekti të ri, pikësëpari duhej përgatitur një flotë e fuqishme, e komanduar mirë "për të sulmuar armiqtë dhe për të mbrojtur Krishterimin në Levant"⁹⁷. Mandej duhej ndihmuar Skënderbeu me së paku 1.000 këmbësorë dhe 200 kalorës. Mbreti Alfons ngulmonte edhe një herë se forcat që do t'i dërgoheshin Skënderbeut do të ndihmonin për t'i shpërndarë osmanët në shumë fronte⁹⁸. Ushtria e madhe e kryqëzatës duhej të shpërthente në mësymje nga fronti hungarez; kryekomandanti duhej të ishte "me autoritet të madh dhe në favor të sipërmarrjes" dhe të qe "Perandor ose Mbret"⁹⁹. Synohej, me sa kuptohet, Frederiku III, për t'iu bindur simbolit të çlirimit të Kostandinopojës, ose ndoshta edhe vetë Alfonsi. Në bashkëpunim me një komandant të tillë do të cakttoheshin numri i ushtarëve të ushtrisë së tokës, si

⁹⁴ Po aty.

⁹⁵ ACA, Reg. 2661, fl. 76 recto-76 verso. RADONIC: Djuradj, nr. 84, 85.

⁹⁶ ACA, Reg. 2697, fl. 162 recto-163 recto. RADONIC: Djuradj, nr. 86.

⁹⁷ "... che se debe in offensione de li inimici e defensione de la christianita in Levante", po aty.

⁹⁸ "Secundario provedere de gente ad Scanderbecho a lo mancho de fanti mille et cavalli docento utili et non de conducta per che a benche estado pocho stimato questo ricordo facto per lo dicto S[canderbecho] a la Soa Sanctita pare a lo dicto Se sea una de le necesarie cose questa per divertire la potencia de lo Turcho in tante parte, che non posa fare lo male che lassiano faria", po aty.

⁹⁹ "Primo capitaneo che sea de grande autorita etd e favore a la impresa et che sea Imperatore o Re", po aty.

dhe numri i anijeve të flotës. Por, paraprkisht, për t'i bërë të mundshme të gjitha këto, duhej mbledhur një shumë e madhe të hollash¹⁰⁰. Prej nëntekstit të këtij projekti kuptohet që Skënderbeut i rezervohej një rol thesht mbrojtës, përforcuar nga kontingjentet e mundshme të Papës, gjithnjë si vasal i Mbretit të Aragonit, Napolit dhe Siqilisë.

Projekte të ngjashme kryqëzate u përpunuan gjatë atij viti edhe në Ratisbonnë në pranverën e 1454-s, në Frankfurt në vjeshtën e po atij viti, në Vjenë¹⁰¹ etj. Në Kuvendin e Rastisbonës u vu gjithashtu në dukje roli që duhej të luanin arbërit në kryqëzatën e projektuar¹⁰²; në këtë Kuvend i qe propozuar Papës të përfshihej në bashkëpunim edhe emiri i Karamanies, armik i njohur i osmanëve¹⁰³. As Duka i Burgundjes Filipi III, në Kuvendin e Frankfurtit, nuk e harronte pjesën që duhej të merrnin arbërit në këtë kryqëzatë në përgatitje e sipër¹⁰⁴. (Në një ceremoni kërshtërore të quajtur "Festa e Fazanit", zhvilluar në Lilë më 1454, Filipi i Mirë qe zotuar botërisht "të rrokte kryqin"¹⁰⁵ dhe Nikolla V e kishte thirrur edhe atë "atlet shumë i egër i fesë dhe luftëtar i patrembur kundër përpjekjeve

¹⁰⁰ "Secundo grande suma de denaro per fare doi grandi exerciti: uno per terra e altro per mare, la quantitate de li quali exerciti se pora deliberare con lo capitaneo, che era electo per la dicta impresa", po aty.

¹⁰¹ VOIGT: Piccolomini, II, 104-118. PASTOR: Geschichte, I, 619-621. JORGA: Notes, IV, 90-91. Po ai: Geschichte des Osmanischen, II, 58.

¹⁰² MARINESCO: Alphonse, 69-70.

¹⁰³ MAKUŠEV: Rezyskanija, 31. JORGA: Geschichte des Osmanischen, II, 31.

¹⁰⁴ JORGA: Notes, IV, 95.

¹⁰⁵ E përshkruan ARENST: Beschreibung der Festfeier etj. Treviri 1868.

shumë të ndyra të një armiku të tillë"¹⁰⁶ Në mënyrë të posaçme u ndien dy kuvendet hungare, që u mblodhën më 1454 dhe 1455. Nga ana e Fuqive të krishtera Hunyadi-t me fuqitë e tij i parashikohej "vendi i parë" në kryqëzatë. Për Nikollën V ai mbetej "Paladini i Krishterimit"¹⁰⁷ dhe, për këtë arsye, Papa ngulmonte t'i shtynte hungarezët në kryqëzatë. Këtë mision ai ia kishte besuar legatit të tij në Oborrin hungarez Giovanni de Castiglione. Në Kuvendin që mbreti hungarez kishte mbledhur në Budë në janar 1454 zotëroi krahu për luftë kundër osmanëve. Hunyadi zëmadv u zgjodh komandant i përgjithshëm për një vit dhe u dekretua mobilizim i përgjithshëm. Simbas këtij mobilizimi, jo vetëm pronarët e vegjël dhe të mëdhej të tokave, por edhe priftërinjtë detyroheshin me shërbimin ushtarak. Fisnikët që do të braktisnin tokat e tyre pa shkaqe bindëse, do të ndëshkoheshin me humbjen e pasurive, për të njëjtin krim jofisnikët do të dënoheshin me vdekje. Megjithëkëtë, nga sa tregon historiani i mbretërisë së Hungarisë, Hunyadi që i ndërgjegjshëm se ushtria e tij ishte ende e dobët për një fitore përfundimtare¹⁰⁸.

Në këto gatitje e sipër për "kryqëzatën" nga ana e Perëndimit, mësohej se në dhjetor 1454 ushtria osmane e komanduar nga një pasha po niste një ekspeditë të re. Simbas njoftimit që i bënte Senatit të Venedikut nënkapiteni i Gjirit Leon Venerio, Skënderbeu "është trembur shumë dhe ndodhet në

¹⁰⁶ "... fidei ferocissimus athleta et intrepidus pugil contra turpissimi histis huiusmodi conatus". Nuper cum, MCCCCLIV, VI Id. Mart. Simbas CERONE: La politica, XXVII, II, 426, shën. 1.

¹⁰⁷ KAYSER: Nicholaus, 215 dhe vij.

¹⁰⁵ E përshkruan ARENST: Beschreibung der Festfeier etj. Treviri 1868.

¹⁰⁸ KATONA: Historia, VI, 952 vij. ZINKEISEN: Geschichte, II, 71-76.

¹⁰⁶ "... fidei ferocissimus athleta et intrepidus pugil contra turpissimi histis huiusmodi conatus". Nuper cum, MCCCCLIV, VI Id. Mart. Simbas CERONE: La politica, XXVII, II, 426, shën. 1.

ikje"¹⁰⁹. Me sa kuptohet prej një mesazhi që dogja i Vendikut Francesco Foscari i dërgonte më 29 janar 1955 Dukës së Milanos Francesco Sforza, fushata e osmanëve drejtohej pikësëpari kundër Serbisë së Brancovicit: osmanët kishin pushtuar "thujse gjithë mbretërinë e Serbisë", si dhe kishin zënë Sofien¹¹⁰; në ndihmë të serbëve u detyrua atëherë të zbriste Hunyadi¹¹¹. Në shkurt një ambasador i Skënderbeut regjistrohet në oborrin e mbretit Alfons, si dhe në atë të Dukës së Napolit, për të kërkuar ndihma¹¹². Nga ana tjetër, në letrat e detyrës me të cilat dogja Foscari pajiste më 13 mars 1455 një Johan Bollano si "proveditor të Durrësit dhe orator në viset e Arbërisë", lexohen në hollësi masat e Republikës për të fortifikuar qytetet e saj Durrës, Lezhë, Shkodër, Drisht dhe Danjë, por edhe për të kontaktuar me prijësit arbër, Skënderbeun, Aranitin dhe Muzakë Topinë, në pritje të ekspeditave osmane¹¹³. Nga ana tjetër, edhe mbreti Alfons detyrohej të ndërhynte në mars 1455 mbi

¹⁰⁹ "... sta in grandissimo timor et fuga". ASV, Secreta consilii Rogatorum, XX, fl. 52. LJUBIC: Listine, X, nr. LVI. RADONIC: Djuradj, nr. 87.

¹¹⁰ ASM, Carteggio gen. Sforzasco, ad annum 1455. RADONIC: Djuradj, nr. 89.

¹¹¹ JIRECEK: Geschichte der Serben, II, 101-102. JORGA: Geschichte des Osmanischen, II, 56, shën. 3.

¹¹² ACA, Reg. 2669, fl. 132 verso-133. MARINESCO: Alphonse, 87.

¹¹³ "... quod procures per illa media et modos, qui tibi utiliores videbuntur, de inducendo magnificum Scandarbegum, Arnitum et Musachium Thopia et alios dominos illarum partium, quod mittant operarios suos ad dictum opus"; "... quod in aliqua alia re non expendantur quam in fabrica predicta, excepto salario bayli nostri, tui provisoris, ingeniarii, castellani, somestabilium et omnium stipendiariorum et excepta provisione Scanderbegi et Musachii Thopie". ASV, Senato Deliberazioni da Mar, V, fl. 77. LJUBIC: Listine, X, nr. LXII. RADONIC: Djuradj, nr. 90.

vasalin e tij Muzakë Topia, duke i bërë thirrje nderit të tij: që të rrafshonte mosmarrëveshjet me Skënderbeut (të cilin e kishte kunat) dhe t'i bindej nënmbretit në Arbëri Ramon d'Ortafa¹¹⁴.

Pak a shumë në të këtilla kontingjenca, në në mars 1455 vdiste Nikolla V duke lënë në mes edhe projektin e kryqëzatës. Në shtratin e vdekjes thërriste përreth kardinalët dhe u mbante një fjalim që u quajt Testamenti i tij; në të Papa shprehej me fjalë të hidhura për princërit e Europës¹¹⁵.

Me vdekjen e Nikollës V u zgjodh papë kardinali i moshuar Alfonso Borgia, i cili mori emrin e Kalikstist III. Fill mbas zgjedhjes, ky bëri betimin: "Unë papë Kaliksti III premtoj dhe i betohem Trinisë, së Shenjtë At Bir dhe Shpirt i Shenjtë, gjithnjë të virgjërës Nënë të Zotit, Shenjtëve Apostuj Pjetër dhe Pal dhe të gjitha ushtrive qiellore, se deri me flijimin e gjakut tim, po të jetë nevoja, do të bëj gjithçka të mundshme për të fituar së rishti, me ndihmën e këshillit të vëllezërve të mi të nderuar, Kostandinopojën që, për ndëshkim të gjenit njerëzor mëkatnor, u pushtua dhe shkatërrua prej armikut të Kryqit Shelbues, prej birit të djallit Muhamet, për të çliruar poashtu të krishterët që lëngojnë në skllavëri, për të ngritur së rishti besimin e vërtetë dhe për ta shkullur në Orient sektin djallëzor të të pabesit dhe të nëmurit Muhamet. Se në të harrofsha ty, Jerusalem, rëntë në harresë e djathta ime, m'u ngriftë gjuha në gojë sa herë mos të kujtohem për ty, Jerusalem, dhe mos të paça ty

¹¹⁴ "Ve respondemo, pregandove et exhotrandove, che lassando stare da parte qualunqua differencie et disensionì, che vuy haggiare havuti con lo magnifico Georgio Castrioti, alias Scanderbecho, attendiate ad fare lo devere et honore vestro et ve vogliate sempre aderere et intendere con lo nostro Vicere in quesse parte, miser Raimundo de Ortoffa. Da questo vuy ne farrite piacere assai et satisfarite al vestro honore". ACA, Reg. 2659, fl. 145. RADONIC: Djuradj, nr. 91, 92.

¹¹⁵ Teksti në MANETTI: Vita, 947 vij. Nuk përjashtohet mundësia që fjalimi të jetë ribërë dhe stilizuar nga ky jetëshkrues i tiji. PASTOR: Geschichte, I, 508 shën. 2.

fillin e gazit tem. Kështu më ndihhtë Zoti dhe Ungjilli i Shenjtë i tij. Amen"¹¹⁶. Fjalë kaq të ashpra nën kupolën e Shën Pjetrit nuk qenë dëgjuar prej kohësh. Nga profesioni Papa ishte jurist, madje dijetar i shquar. Por ishte edhe spanjoll, me emrin e vërtetë Alonzo de Borja, dhe tradita spanjolle e luftërave shumëshekullore me maurët dhe e konfliktit me Islamin dukej se ringjallej tek ai¹¹⁷. "Në historinë e popujve të tjerë kryqëzatat s'përbëjnë veçse një episod, - shënon duke folur për këtë papë baroni Von Pastor, - kurse ekzistimi i popullit spanjoll ka qenë një kryqëzatë e vijueshme"¹¹⁸. Historiani i papëve vë re madje se asnjë papë nuk pati ndërmarrë me një "zell" dhe "energji" të tillë një kryqëzatë si Kaliksti III¹¹⁹. Akti i tij i parë praktik ishte konfirmimi, madje zgjerimi, i "bullës kryqtare" të paraardhësit të tij pa mbushur as muajin nga zgjedhja papë.

Viti 1455 ishte një vit mësymjeje nga ana e osmanëve, të cilët nuk donin ta linin të organizohej Perëndimin në përgatitje e sipër të "kryqëzatës"; ky vit duket se qe shumë i vështirë për Skënderbeun. Qysh në prill 1455 një ushtarak i quajtur Antonio Palerino de Palerino mbërrinte pranë tij si i dërguar i mbretit Alfons¹²⁰. Ai i sillte Skënderbeut informacionin për "kryqëzatën e

¹¹⁶ Betimi gjendet në shumë kodikë të shek XV. Këtu nga DE MONTAULT: Oeuvres, I, 386. Edhe PASTOR: Geschichte, I, 672.

¹¹⁷ Më gjerë për këtë papë HARDUIN: Concilia, IX, 1375; PASTOR: Geschichte, I-II; CREIGHTON: History, III, IV; BLUME: Iter Italicum, III; REUMONT: Geschichte, III, 126 dhe vij.; HEFELE: Concilieng., VIII, 74 dhe vij.

¹¹⁸ PASTOR: Geschichte, I, 672.

¹¹⁹ PASTOR: po aty, 670 dhe vij.

¹²⁰ "La Maestà del re questa pascha mandoe Palerino al Scanderbech in Albania a provedere questo payxe et per intendere come fosse apto et sufficiente a sostenatione de gente d'arme". ACA, Reg. 2798, fl.

madhe" që tanimë, mbas "paqes italiane", ishte në përgatitje prej Papës së ri, i cili si kardinal Alonso Borja pati qenë njeri i besuar i mbretit Alfons. Por De Palerino-ja ishte i ngarkuar edhe me një mision të posaçëm rikonjicioni: ai duhej të inspektonte territorin nga i cili do të niste mësymja (kështjella, kalime dhe pozicione të ndryshme) dhe të raportonte mandej në Napoli rezultatet e vrojtimeve të tij në mënyrë që Mbreti të mund të dërgonte me kohë gjithë sa ishte e nevojshme¹²¹. De Palerino-ja do të kthente për të raportuar në Napoli dhe më 22 maj mbreti Alfons do ta niste përsëri për në Arbëri së toku me një kontingjent 1.200 këmbësorësh dhe 500 kalorësish¹²².

Misioni i De Palerino-s kishte të bënte sa me përgatitjen e kryqëzatës në përgjithësi, aq edhe me organizimin e sulmit për marrjen e Beratit. I quajtur "Belgradi shqiptar", Berati paraqiste për mbretin Alfons një rëndësi dore së parë, duke qenë se ai me kështjellën e tij kontrollonte një rajon të tërë siç ishte bregdeti jugor i Arbërisë së paku deri në Vlorë. Sulmi për marrjen e Beratit u krye në maj 1455 me një ushtri "të krishterë" arbëro-napolitane prej 14.000 vetësh të udhëhequr nga kunati i Skënderbeus Muzakë Topia dhe vetë De Palerino-ja. Në kohën që forcat e krishtera i kishin vënë rrethimin kështjellës, më 26 korrik ato u sulmuan në befasi mbas shpine prej një trupe të zgjedhur 40.000 kalorësish turq, dhe u shpartalluan. Të krishterët u masakruan: u vranë ose u zunë robër 5.000

158-159. MAKUŠEV: Monumenta Slav., II, 227; ky e ka dhënë gabim emrin: "Palermo"; e koregjon MARINESCO: Alphonse, 97, shën. 2. RADONIC: Djuradj, 93 dhe shën. 1.

¹²¹ Po aty.

¹²² "Mo [Palerino] è ritornato et ha mi caricato, che di questo ne scrivesse ad V. Sria, raccomandandose a quella et significandoli che la preiibata Maestà ha deliberato remandarlo al prefato Scanderbech cum fanti mille duecento et il Signor Texeo Savello et sancto Garillo cum cavalli cinque cento, sapendo che V. Sria summamente l'havera a piacere", po aty.

deri 6.000 ushtarë, vetë Muzakë Topia u vra, De Paleriono-ja shpëtoi vetëm me rreth 300 këmbësorë¹²³. Ambasadori i Dukës së Milanos në Napoli, Albrico Malleta, në raportin e 8 gushtit 1455 për shpartallimin e Beratit, shton edhe këtë: "Dhe mbërriten këta turq deri në bregun e detit, breg prej të cilit për një natë kalohet lehtë në Itali nga porti i Brindisit, qyteti i princit të Tarantit. Dhe gjithë ditën vikasin këta turq dhe thonë se duan të kalojnë në Brindisi. Dhe kur ushtria e turqve, që ndodhet kundër Rudit, të vinte shpejt në këtë ngushticë të Brindisit dhe të bashkohej me këtë ushtri

¹²³ "E ritrovandose Scanderbech cum Palerino a campo contra quello loco in nome delo Re, supervene lo exercito del Turcho e rupeno el dicto campo. E secondo me ha dito uno cognato de Palerino, el qualle vene hieri, sono stati tra presi e morti da V in VI m. Cristiani. E stato preso uno Signor Mosacho, cognato de Scanderbech. E de li mile fanti de Palerino gli ne rimasto piu de CC. Heri el dicto cognato de Palerino ando da la Maestà del Re a dargle per parte de Palerino quanto era segiuto". MAKUŠEV: Monumenta Slav., II, 148-149. PISKO: Skanderbeg, 38-139. RADONIC: Djuradj, nr. 96. "Hieri che fu a 7 de Augusto sono venuti molti fanti, li quali dicano e confirmano de visu, che siando andato el Signor Schanderbech de Albania, arecommendato dela Maestà del Re a campo ad uno castello del Turcho, chiamato Beligradi, cum circa 14.000 persone, tra li quali gli erano anche fanti de la Maestà del Re, e delliberando de dare la bataglia cum ferma speranza de havere quello passo, el quale era de grandissima importantia e prejuditio al Turcho, gli superveneno da circha 40.000 cavalli de le piu elete gente che avesse el Turcho, le qualle feceno un tanto presto cavalcare, che non se vedeva per quelli del campo havesseno potuto venire cum tanta celerita. Et intrarono in questo campo per vie non may usate cum tanto furore, che rupeno el dicto campo, e hanno tra morti e presi da cinque in sey mila Cristiani. E se la note non gli havesse ajutati, niuno campava". MAKUŠEV: Monumenta Slav., II, 150-151. RADONIC: Djuradj, nr. 95.

[të këtushme], mjerë Italia e gjithë, se nuk do të ketë nga t'ia mbajë"¹²⁴. Lajmi ra si rufe në oborrin e mbretit Alfons, si për humbjet e mëdha të pësuar aty, edhe për rëndësinë gjeo-strategjike që Mbreti i jepte Beratit. I njëjti Albrico Malleta, i cili informohej nga një kunat i De Palerino-s, i raportonte Dukës së tij në Milano: "Dhe thotë se Madhëria e Tij [Mbreti] u hidhërua shumë, duke thënë gjithashtu se, sikur Madhëria e Tij ta kishte marrë kështjellën në fjalë, që kontrollonte me lehtësi një vis shumë të madh të Turkut deri në Vlorë, Turkut nuk do t'i mbetej rrugë kalimi për të ardhur në këto troje që ai [Mbreti] i zotëron përkundrejt në Taranto dhe Brindisi"¹²⁵. Shpartallimi i ushtrisë së krishterë në Berat do të vishej edhe me një mistikë të vetën. I biri i Simon Zenebisit, edhe ky vasal i Mbretit Alfons, që mbërrinte në oborrin e Napolit pak mbas betejës së Beratit (gusht 1455), tregonte dy mrekulli. E para: në fushën e betejës ku dergjeshin trupat e të vvarëve, si të të krishterëve ashtu edhe të turqve, natën shiheshin qartë disa ndriçime të çuditshme që dukeshin sikur zbrisnin nga yjet

¹²⁴ "E sono transcorsi questi Turchi perfino al lito del mare, dal qualle lito in una note facilmente se intra in Italia nel porto de Bronduso, cita del principio de tarante. E tuto lo di cridavano questi Turchi e dicano de volere passare a Brondussa. E quando la armata de li Turchi, che e contra Rodi, venese presto a questo passo de Brondise ad unirse cum quello exercito, guay a tuta Italia, non siandoli altra provisione". MAKUŠEV: Monumenta Slav., II, 150-151. RADONIC: Djuradj, nr. 95.

¹²⁵ "E dice, che ma Maestà del re se ne trova molto de mala voglia, digando etiamdio, che se la Maestà del re havesse ottenuto el dicto castello, cha facilmente obtineva uno grandissimo paese del Turcho perfino ala Valona, perche non remagniva passo al Turcho de venire a queste terre, le qualle luy tene per contra de Taranto e de Brundiso". MAKUŠEV: Monumenta Slav., II, 148-149. PISKO: Skanderbeg, 38-139. RADONIC: Djuradj, nr. 96.

vetëm mbi trupat e të krishterëve dhe jo të tuqve¹²⁶. E dyta: kur kishin vajtur turqit për të varrosur trupat e të vrarëve, i gjetën trupat e turqve gjysmë të kalbur dhe të shqyer nga ujëti dhe shtazët e tjera, ndërsa trupat e të krishterëve ishin të paprekur dhe pa kurrfarë ere¹²⁷.

I tronditur nga humbja e madhe, mbreti Alfons vijoi t'i dërgonte ndihma vasalit të vet: më 25 gusht ai i jepte Giovanni Catalano-s, komandant i balestrierëve dhe i këmbësorëve, një flamur taftaje të gjelbër me thekë mëndafshi, me një balestër të qëndisur në mes dhe një "Siti Perillos"¹²⁸. Meqenëse "kryqëzata" lypsej të kishte edhe prijësit fetarë, ai dërgonte në Arbëri edhe një Fra Juan Claver me katër flamuj të tjerë me armprët e Aragonës¹²⁹. Për ndihmat e dërguara nga mbreti Alfons në këtë kohë me anë të përfaqësuesve ushtarakë të Skënderbeut njofton edhe Summonte-ja, i cili i quan ata "zotërinj të ardhur nga Arbëria"¹³⁰. Simbas Summonte-s, ndihma përbëhej prej 1.000

¹²⁶ "E in quello loco, dove fu fata la bataglia, unde erano misculati li corpi de li Cristiani e de li Turchi, la note se vedeva chiaramente certi razi e splendori, che parevano descendere da le stelle sopra li corpi de li Cristiani e non de li Turchi". MAKUSEV: Monumenta Slav., II, 147-148. RADONIC: Djurad, nr. 97.

¹²⁷ "Laltro miraculo, che andagando li Turchi per volere sepolire questi corpi, trovarono la mazor parte de li soy corpi molto putredi e straziati e lazarati da lupi e da altre fire bestie e li corpi de li Cristiani trovarono integri e senza fetore alcuno", po aty.

¹²⁸ MINIERI-RICCIO: Alfonso, VI, III, 432. CERONE: La politica, XXVIII, I, 182. MARINESCO: Alphonse, 101, shën. 2.

¹²⁹ MINIERI-RICCIO: po aty, 434. CERONE: po aty, 181. MARINESCO: po aty, 101, shën. 3.

¹³⁰ SUMMONTE: Storia, I, 529. Simbas TIVARASIT ishin Pal Kuka, Nikollë Erizi, Gjon Perlati te BIEMMI: Istoria, 310.

këmbësorësh arkibugjerë dhe balestrierë, "aq njerëz sa [Skënderbeu] jo vetëm mbrojti shtetin e tij, por fitoi edhe disa kështjella të Turkut"¹³¹.

Me gjithë këto ndihma, situata e Skënderbeut mbas shpartallimit në Berat nuk dukej të përmirësohej, madje shtoheshin edhe humbje të tjera, si kuptohet nga lajmet për "luftime të përgjakshme"¹³². Mbas fitores së Beratit osmanët shtinë në dorë territorin që mbërrinte deri në afërsi të Krujës¹³³. Gjatë gjithë vjeshtës ata rrënuan viset e pushtuara duke kryer "mizori të tmerrshme" dhe duke marrë për skllavë gra e fëmijë¹³⁴. Në Napoli madje druhej se mos e gjithë Arbëria binte në duar të osmanëve¹³⁵. Në një relacion të ambasadorit të Dukës së Milanos Albrico Maleta-s, të datës 8 dhjetor 1455, tregohet se osmanët ishin dyndur në Arbëri dhe vijonin të përparonin¹³⁶. Edhe në një relacion nga oborri papnor, po për Dukën e Milanos por prej Jacobo Calcaterra-s, relatohej se Papa ishte njoftuar për një ndeshje të rreptë në fund të 1455-s në "Arbërinë e Skënderbut", "në të cilën, sikurse shkruhet, u vranë e u zunë robër njerëz shumë dhe pa fund"¹³⁷. Hopf-i dhe, mbas tij, Pastor-i

¹³¹ COSTANZO: Storia, I, 529.

¹³² MAKUŠEV: Razyskanija, 97. Po ai: Monumenta Slav., II, 196. PISKO: Skanderbeg, 140.

¹³³ MAKUŠEV: Razyskanija, 97. Po ai: Monumenta Slav., II, 152. MARINESCO: Alphonse, 104.

¹³⁴ Po ata, po aty.

¹³⁵ Po ata, po aty.

¹³⁶ "Habbiamo aviso in questa terra, che li Turchi sono corsi molto grossi in Albania. E hano preso molte terre per fine apresso ala Croya, cita delo Re a octo miglia... ecc.". MAKUŠEV: Monumenta Slav., 152-153. RADONIC: Djuradj, nr. 103.

¹³⁷ "Hogi a la Stà del papa [...] sono gionte lettere, nele quale se narra come il Turcho et la gente sua hano havuto in questi di proximi duoy grandissimi conflicti, l'uno apresso de Syo, l'altro in Albania da lo

vërejnë se për disa kohë mbas shpartallimit në Berat Skënderbeu u përfill në Perëndim si "i zhdukur" dhe vetëm në fillim të vitit 1456 do të shfaqej përsëri¹³⁸.

Scanderbech, nel quale, secondo se scrive, e facta occisione e captivita de molte et infinite persone".

MAKUŠEV: Monumenta Slav., 196. RADONIC: Djuradj, nr. 106.

¹³⁸ HOPF: Griechenland, II, 134. PASTOR: Geschichte, I, 737.